

VENDIM
Nr. 326, datë 28.5.2014

**PËR NJOHJEN DHE SHLYERJEN E DETYRIMIT TË MINISTRISË SË MBROJTJES SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË KUNDREJT DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARMATIMIT
NË MINISTRINË E MBROJTJES SË REPUBLIKËS SË FRANCËS, PËR KONTROLLIN TEKNIK TË
KRYER GJATË PROCESIT TË PRANIMIT TË TRE HELIKOPTERËVE COUGAR AS532AL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 185/2013, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Njohjen dhe shlyerjen e detyrimit të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Armatimit në Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Francës, për kontrollin teknik të kryer gjatë procesit të pranimi të tre helikopterëve Cougar AS532AL, të blerë nga Ministria e Mbrojtjes sipas kontratës nr. 6853/10, datë 17.12.2009, me objekt “Për blerjen e 5 helikopterëve të mesëm shumërolësh AS532AL”, ratifikuar me ligjin nr. 10222, datë 4.2.2010, të ndryshuar, në shumën 180 000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) euro, e konvertuar në lekë.

2. Efektet financiare për shlyerjen e këtij detyrimi të përballohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Mbrojtjes në programin buxhetor “Forcat e luftimit”, artikulli 231, “Shpenzime kapitale”.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama